

**Njoftim për përqendrimin me të cilin ENNA SOLAR shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
për këshillim dhe shërbime, Republika e Kroacisë, do të fitojë kontroll mbi PVP
Cepheus S.R.L., Republika e Rumanisë
(lënda nr. 08-82/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më 30.04.2025, dhe plotësuar më 09.05.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka pranuar një njoftim për përqendrim me të cilin ENNA SOLAR shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për këshillim dhe shërbime (ENNA SOLAR d.o.o.), me seli në adresën Zona Industriale Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë PVP Cepheus S.R.L., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në adresën 45H Drumul Gura Putnei, kati i parë, apartamenti 5, dhoma 1, Rrethi 3, Bukuresht, Rumani.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

ENNA SOLAR d.o.o. është shoqëri e themeluar dhe ekziston sipas ligjeve të Republikës së Kroacisë dhe merret me zhvillimin dhe investimin në impiante për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, siç janë centralet diellore dhe ato me erë.

ENNA SOLAR d.o.o. është pjesë e grupit ENNA. ENNA është investitori kryesor dhe një nga grupet më shpejt në rritje të investimeve në Kroaci, e përkushtuar në ofrimin e zgjidhjeve inovative që nxisin transformimin e gjelbër dhe krijojnë vlerë të qëndrueshme për partnerët dhe komunitetin, si në sektorin energjetik, ashtu edhe në sektorin e transportit dhe logistikës.

ENNA SOLAR d.o.o. ka qëllim me transaksionin të fitojë 100% të pjesës në Shoqërinë e synuar dhe, pas përfundimit të transaksionit, përmes PVP Cepheus S.R.L. do të vazhdojë ndërtimin, funksionimin dhe menaxhimin e projektit (konkretisht, do të shesë energjinë elektrike të prodhuar nga projekti).

PVP Cepheus S.R.L. është shoqëri e themeluar dhe ekziston sipas ligjeve të Republikës së Rumanisë. Kjo shoqëri është themeluar për realizimin e projektit për ndërtimin e një centrale fotovoltaike, ku Shoqëria e synuar është pronare ose mbajtëse e të gjithë pasurisë, kontratave, lejeve (dhe të drejtave që lidhen me centralin fotovoltaiik „Mihailesti-Bulbucata“, me lidhjet e rrjetit dhe infrastrukturën ndihmëse, e vendosur pranë Mihailesti, në rrethin Giurgiu, Rumani), me kapacitet prej 68,115 MW („Projekti“).

PVP Cepheus S.R.L. nuk ka prezencë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në territorin e saj.

Bazuar në shqyrtimin preliminar, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe opinione për këtë përqendrim deri te Komisioni. Vërejtjet dhe opinionet mund të dërgohen në adresën: rruga „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose në email: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë te Komisioni brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

12.05.2025

Shkup